

## Syllabusi për lëndën: Etiologjia e krimit

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Etiologjia e krimit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>E obliguar</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti I, Semestri I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E hënë, ora: 13.00-16.00, Salla D4.</b>
<b>Viti akademik</b>	<b>2017/2018</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Dr.sc.Rexhep Gashi, profesor i rregullt</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Email: <a href="mailto:rexhep.gashi@uni-pr.edu">rexhep.gashi@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda e Etiologjisë së krimit përfshin trajtimin shkencor të çështjeve themelore që kanë të bëjnë me faktorët e kriminalitetit në shoqërinë bashkëkohore. Në kuadër të kësaj disipline shkencore paraqiten dhe analizohen qasjet e ndryshme teorike dhe shkencore që kanë të bëjnë me dhënien e përgjigjes në pyetjen se përse njerëzit kryejnë krime dhe cilët janë ata faktorë që e kushtëzojnë kriminalitetin. Objekt studimi i kësaj disipline shkencore do të jenë disa nga temat si: Teoritë dhe historiku i mendimeve mbi faktorët kriminogjen; Kuptimi dhe pikëpamjet e ndryshme lidhur me kuptimin e faktorëve kriminogjen, e veçmas do të paraqiten dhe analizohen veç e veç faktorët objektiv (të jashtëm) të kriminalitetit si dhe ata subjektivë (të brendshëm) të kriminalitetit. Gjatë trajtimit të këtyre njësive mësimore studentët do të kenë mundësi të kenë qasje në burime të shumta bashkëkohore dhe materiale tjera shtesë të kësaj fushe.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë mësimore ka për qëllim që të ndihmojë studentët e studimeve të programit master që të fitojnë njohuri të reja si dhe t'i thellojnë edhe më tej njohuritë e tyre ekzistuese lidhur me shkaqet e kriminalitetit në shoqërinë bashkëkohore. Përmes qasjes së tyre në burime të shumta të kësaj fushe, studentët, pas përfundimit të kësaj lënde do të jenë</p>

	<p>më të kompletuar me njohuri të avancuara shkencore të fushës së etiologjisë së krimit. Po ashtu, ata do të jenë në gjendje që ti krahasojnë rezultatet e arritura shkencore të fushës së etiologjisë së krimit me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë si dhe ti zbatojnë ato rezultate me sukses në fushën e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të studimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të jetë i kompletuar me njohurit të avancuara shkencore lidhur me qasjet e ndryshme torike dhe metodologjike mbi faktorët e kriminalitetit.</li> <li>2. Të përcjellë dhe krahasojë rezultatet e arritura shkencore në fushën e Etiologjisë së krimit dhe të përdorë këto rezultate në procesin e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit;</li> <li>3. Të jetë sa më tepër i familjarizuar me qëndrimet dhe rezultatet shkencore të autorëve të njohur ndërkombëtarë të kësaj fushe të studimit, përfshirë edhe aftësimin e tij që të ketë qasje kritike ndaj pikëpamjeve të autorëve të ndryshëm lidhur me shkaqet e kriminalitetit;</li> <li>4. Të zbatojë njohuritë dhe rezultatet e shkencës së Etiologjisë së krimit në praktikën e luftimit dhe parandalimit të suksesshëm të kriminalitetit.</li> </ol>

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me	10 min.	15	1.5

mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	2	8
Projektet,prezentimet ,etj	3	2	6
<b>Totali</b>			<b>132.5</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Metodologjia e mësimdhënies do të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-<b>Ligjërata interaktive:</b> Në pjesën më të madhe të kohës do të organizohen ligjërata interaktive që d.m.th. se përveç ligjërimit nga ana e mësimdhënësit, kyçen edhe studentët, qoftë duke pyetur apo edhe duke diskutuar dhe këmbyer mendimet e tyre lidhur me çështjet tematike që janë objekt i ligjërates.</li> <li>- <b>Punimet seminarike:</b> Studentët do të kenë mundësi të përcaktohen për ndonjë temë apo punim seminarik, ku para fillimit të punës së tyre, atyre u ofrohen udhëzimet elementare lidhur me hartimin e punimeve të tilla, dhe pas përfundimit të tyre ata kanë mundësi të prezantimit para studentëve të tjerë të rezultateve të punimeve të këtilla, ku edhe do të zhvillohen debate lidhur me temat e trajtuara.</li> <li>- <b>Ndarja në grupe të vogla të studentëve:</b> Do të bëhet përpjekje në aplikimin e punës grupore me studentë, ku ata ndahen në grupe të vogla me qëllim të debatimit dhe kyçje së këtyre grupeve në trajtimin e temave të ndryshme që do të jenë objekt i ligjërimit.</li> <li>- <b>Zbatimi i metodave bashkëkohore të ligjërimit:</b> Gjatë punës me studentë do të përdoren metoda dhe teknika të tjera dhe bashkëkohore të ligjërimit të cilat do të jenë në funksion të shpjegimit të problemeve themelore të shkaqeve të kriminalitetit në mënyrë që studentët të kenë mundësi të kyçen pa probleme në nxënien dhe përvetësimin e</li> </ul>
-------------------------------------	--

	materies që është objekt trajtimi.																																
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p><i>Vlerësimi i studentëve bazohet në format e fitimit të pikëve të shprehura në % si vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Vlerësimi i parë intermediar.....20%</li> <li>-Vlerësimi i dytë intermediar.....15%</li> <li>- Punimi seminarik.....10%</li> <li>-Vijimi i rregullt dhe pjesëmarrja aktive.....5%</li> <li>-Provimi final.....50%</li> <li>-Totali.....100%</li> </ul> <p><b>Përshkrimi i sistemit të notimit:</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nota</th> <th>ECTS nota</th> <th>Pike</th> <th>Përkufizimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10</td> <td>A</td> <td>91–100 %</td> <td><b>SHKËLQYESHËM</b>- njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>B</td> <td>81 – 90 %</td> <td><b>SHUMË MIRË</b> – mbi mesatare standarde,por me disa gabime</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>C</td> <td>71 – 80 %</td> <td><b>MIRË</b> – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>D</td> <td>61 – 70 %</td> <td><b>KËNAQSHËM</b> – mire, por me mjaft gabime</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>E</td> <td>51 – 60 %</td> <td><b>MJAFTON</b> – rezultatet plotësojnë kriteret minimale</td> </tr> <tr> <td>5*</td> <td>FX</td> <td>40 – 50 %</td> <td><b>DOBËT</b>– kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>F</td> <td>00 - 39 %</td> <td><b>DOBËT</b> – kërkohet shumë punë për të fituar kredi</td> </tr> </tbody> </table>	Nota	ECTS nota	Pike	Përkufizimi	10	A	91–100 %	<b>SHKËLQYESHËM</b> - njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore	9	B	81 – 90 %	<b>SHUMË MIRË</b> – mbi mesatare standarde,por me disa gabime	8	C	71 – 80 %	<b>MIRË</b> – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen	7	D	61 – 70 %	<b>KËNAQSHËM</b> – mire, por me mjaft gabime	6	E	51 – 60 %	<b>MJAFTON</b> – rezultatet plotësojnë kriteret minimale	5*	FX	40 – 50 %	<b>DOBËT</b> – kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë	5	F	00 - 39 %	<b>DOBËT</b> – kërkohet shumë punë për të fituar kredi
Nota	ECTS nota	Pike	Përkufizimi																														
10	A	91–100 %	<b>SHKËLQYESHËM</b> - njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore																														
9	B	81 – 90 %	<b>SHUMË MIRË</b> – mbi mesatare standarde,por me disa gabime																														
8	C	71 – 80 %	<b>MIRË</b> – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen																														
7	D	61 – 70 %	<b>KËNAQSHËM</b> – mire, por me mjaft gabime																														
6	E	51 – 60 %	<b>MJAFTON</b> – rezultatet plotësojnë kriteret minimale																														
5*	FX	40 – 50 %	<b>DOBËT</b> – kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë																														
5	F	00 - 39 %	<b>DOBËT</b> – kërkohet shumë punë për të fituar kredi																														
<b>Literatura</b>																																	
<b>Literatura bazë:</b>	Dr.Ragip Halili, <i>Kriminologjia</i> , Prishtinë, 2016.																																
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>L. J.Siegel, B.C.Welsh, J.J.Senna, <i>Juvenile Delinquency (theory, practice, and law)</i>, Thomson &amp; Wadsworth, 2006.</p> <p>J.Robert Lily, Francis T.Cullen, Richard A. Ball, <i>Criminological Theory- Context and Consequences</i>, 5<sup>th</sup> edition, Sage, 2011.</p> <p>Mike Maguire, Rod Morgan, Robert Reiner, <i>The Oxford handbook of Criminology</i>, Third Edition, Oxford University Press, 2002.</p>																																

	<p>Chris Hale, Keith Hayward, Azrini Wahidin, Emma Wincup, <i>Criminology</i>, Oxford University Press, 2005.</p> <p>Travis Hirschi, <i>Causes of Delinquency</i>, Transaction Publishers, 2002.</p> <p>Stephen Jones, <i>Criminology</i>, Third Edition, Oxford University Press, 2006.</p> <p>Suzette Cate (Editor), <i>Criminological Theories, (Bridging the Past to the Future)</i>, Saga publications, 2002.</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Kuptimi i shkencës së Etiologjisë së kriminologjisë</li> <li>- Lënda e studimit të Etiologjisë së kriminologjisë</li> <li>-Metodologjia dhe metodat e studimit të Etiologjisë së kriminologjisë</li> </ul>
<b>Java e dytë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Teoritë dhe historiku i mendimeve mbi faktorët e kriminologjisë;</li> <li>-Mendimi antik mbi shkaqet e kriminalitetit</li> <li>-Mendimi mesjetar mbi shkaqet e kriminalitetit</li> <li>-Mendimet humaniste dhe historiko-juridike</li> <li>-Teoria antropologjike</li> <li>-Teoritë pozitiviste italiane</li> <li>-Teoritë biologjike</li> <li>-Teoritë psikologjike</li> </ul>
<b>Java e tretë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Teoritë sociologjike mbi faktorët e kriminologjisë</li> <li>-Mendimet e shkollës së mbrojtjes së re shoqërore</li> <li>-Teoritë e reja sociologjike ose amerikane</li> <li>-Teoritë e interaksionit dhe etiketimit</li> <li>-Mendimi shqiptar mbi faktorët kriminologjicë</li> </ul>
<b>Java e katërt:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Kuptimi i faktorëve kriminologjicë</li> <li>-Pikëpamjet mbi faktorët kriminologjicë</li> <li>-Ndarja e faktorëve kriminologjicë</li> </ul>
<b>Java e pestë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Faktorët ekonomik – shoqëror të kriminalitetit</li> <li>-Industrializimi, urbanizimi dhe kriminaliteti</li> <li>-Migrimi i njerëzve dhe kriminaliteti i të huajve</li> <li>- Krizat, depresionet ekonomike dhe kriminaliteti</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Varfëria dhe kriminaliteti</li> <li>-Papunësia dhe kriminaliteti</li> <li>-Kushtet e vështira të banimit dhe kriminaliteti</li> <li>-Profesioni-mjeshtria dhe kriminaliteti</li> </ul>
<b>Java e gjashtë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Faktorët ideopolitik të kriminalitetit</li> <li>-Konfliktet politike dhe kriminaliteti</li> <li>-Konfliktet kulturore dhe kriminaliteti</li> <li>-Lufta dhe kriminaliteti</li> <li>-Arsimimi dhe kriminaliteti</li> <li>-Mjetet e komunikimit masiv dhe kriminaliteti</li> <li>-Religjioni dhe sektet ekstreme religjioze si faktor kriminogjen</li> </ul>
<b>Java e shtatë:</b>	Vlerësimi i parë intermedial
<b>Java e tetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Faktorët mikrogruporë të kriminalitetit</li> <li>-Familja si faktor kriminogjen</li> <li>-Shkolla dhe ambienti shkollor si faktor kriminogjen</li> <li>-Mjedisi shoqëror-ambienti social si faktor kriminogjen</li> </ul>
<b>Java e nëntë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Faktorët sociopatologjikë të kriminalitetit</li> <li>-Prostitucioni dhe kriminaliteti</li> <li>-Patologjia seksuale dhe kriminaliteti</li> <li>-Alkoolizmi dhe kriminaliteti</li> </ul>
<b>Java e dhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Narkomania dhe kriminaliteti</li> <li>-Bixhozi dhe kriminaliteti</li> <li>-Bredhja, lëmosha dhe kriminaliteti</li> <li>-Dukuria e AID-sit dhe kriminaliteti</li> <li>-Dukuria e vetëvrasjeve</li> <li>-Hakmarrja dhe gjakmarrja</li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Faktorët e brendshëm (subjektiv) të kriminalitetit</li> <li>-Vetitë dhe baza psikike e personalitetit dhe kriminaliteti</li> <li>-Baza biologjike e personalitetit dhe kriminaliteti</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Çrregullimet mentale dhe kriminaliteti</li> <li>-Kuptimi dhe llojet</li> <li>-Neurozat dhe kriminaliteti</li> <li>-Psikopatitë dhe kriminaliteti</li> <li>-Psikozat dhe kriminaliteti</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	-Klasifikimi dhe tipologjia e kriminelëve

	-Roli dhe rëndësia e klasifikimit -Llojet e klasifikimit dhe tipologjisë së kriminelëve
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Përsëritja e lëndës dhe mbrojtja e punimeve seminarike
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Vlerësimi i dytë intermedial

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët gjatë procesit të mësimit, provimeve, por edhe gjatë pranisë së tyre në fakultet duhet pasur kujdes që:

- të respektojnë mësimdhënësin dhe personelin joakademik të universitetit;
- mos të pengojnë procesin mësimor;
- të dëgjojnë me kujdes si mësimdhënësit ashtu edhe kolegët e tyre;
- mos të përdorin ushqim, pije, goma përtypëse në sallë të mësimit;
- mos të përdorin telefonat mobil në sallë të mësimit;
- të hyjnë me kohë në sallë të mësimit;
- mos të kopjojnë gjatë provimit dhe testeve të tjera.